



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

---

Numri i lëndës: 2019:275077  
Datë: 28.02.2022  
Numri i dokumentit: 02761860

ARJ. Nr.10/2022

Gjykata Supreme në Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Ragip Namani, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Muhamet Rexha, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ të paditësit, H. Z. S. nga f. . S....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Ramiz Suka nga Prishtina, kundër të paditurit, Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorëve të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me bazë juridike anulim i vendimit dhe njohjen e statusit të veteranit të Luftës së UÇK-së, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA.nr. 945/2021 të datës 16.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25 Shkurt 2022, merr;

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi H. Z. S. nga f. S....., kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA. nr.945/2021 të datës, 16. 12. 2021.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr. 945/2021 të datës, 16. 12. 2021, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, H. S. e datës 21.10.2021, ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2418/2018, i datës 28.09.2021, me të cilin është hedhë poshtë, padia e paditësit nën shenjën A nr. 2418/18, si e pa lejueshme.

Paditësi për mes të autorizuarit, Av. Ramiz Suka, në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, më të cilën e konteston ligjshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të; shkeljes së rregullave të procedurës administrative, dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale. Propozon që Gjykata

Supreme aktvendimin e Gjykatës së Apelit, AA. nr. 945/2021 të datës 16. 12. 2021, ta anulon si jo të bazuar dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kontestuar, sipas pretendimeve nga kërkesa dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera lëndës, gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pa bazuar.

Nga provat në shkresat e lëndës rezulton se, gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit paraprak të padisë, merr aktvendimin A.nr.2418/2018 dt. 15.12.2020, me të cilin e obligon paditësin ti evitoj të metat e padisë, të përcaktoj se cilin akt e konteston me padi ,përkatësisht të dëshmoj se i ka shtjerrë mjetet juridike në procedurë administrative. Paditësi me parashtresën e dt. 30.12.2020, e konteston aktin e njëjtë të organit të paditur, Certifikatën e „Veteranit Pjesëtarë“, të dt. 16.04.2018. Gjykata e shkallës së parë duke ju referuar nenit 3, par. 1.2, dhe nenit 13 dhe 14 të LKA-së, nxjerr aktvendimin e ankimuar, nr. 2418/18 të dt. 28.09.2021, me të cilin e hudhë padinë e paditësit si të pa lejueshme, në kuptim të nenit 34.1.1.5 të LKA-së, sepse akti të cilin e atakon me padi nuk paraqet akt përfundimtar në procedurë administrative ndaj të cilit mund të filloj konflikti administrativ, po ashtu vlerëson se nuk është provuar se edhe sipas heshtjes administrative ti ketë shtjerrë mjetet juridike, që pastaj ti drejtohet gjykatës me padi. Gjykata Apelit në procedurë ankimore sipas ankesës së paditësit me aktvendimin tani të kontestuar me kërkesë, e konfirmon si të drejtë dhe ligjor vendimin e shkallës së parë, duke vlerësuar njëjtë nga bazat ligjore si gjykata e shkallës së parë, se padia e paditësit është e palejueshme sepse nga provat administruara nga gjykata e shkallës së parë vërtetohet se paditësi nuk i ka shtjerrë mjetet e brendshme juridike të ankimit tek e paditura, përkatësisht tek komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranit të UÇK-së, që pastaj të filloj procedurë gjyqësore si në kuptim të nenit 13 dhe 14 të LKA-së, gjer sa me padi nuk kontestohet ligjshmëria e një vendim administrativ përfundimtar. Gjykata Apelit pretendimet ankimore të paditësit i refuzon si jo të bazuara sepse nuk gjen prova se vendimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje që do të ndikonin në vendosjen ndryshe të kësaj çështje.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjenda e tillë e çështjes pas shqyrtimit të kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të provave tjera në shkresat e lëndës, gjen se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë me hudhjen e padisë së paditësit si të palejueshme nga gjykata e shkallës së parë, dhe refuzimin e ankesës dhe vërtetimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë nga gjykata e shkallës së dytë të kontestuar me kërkesë.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, si të drejtë dhe ligjor në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, nga se aktvendimi i kontestuar me kërkesë i Gjykatës së Apelit por as i shkallës së parë, nuk janë të përfshirë me shkelje të rregullave të procedurës administrative, dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale, ashtu si pretendon paditësi.

Paditësi në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor mes tjerash thekson se; dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim diametral me atë të shkallës së parë, se nga gjykata nuk është formuar një simetri ndërmet palëve në procedurë prandaj gjykata e shkallës së dytë

vlerëson njëjtë si gjykata e shkallës së parë e cila nuk ka respektuar barazinë e palëve ndërgjyqjësë, ndërsa provat dhe deklaratat e ofruara nga paditësi nuk i ka vlerësuar fare lidhur me çështjen kontestuese, se i padituri si komision qeveritar ka lëshuar vetëm njoftime dhe vërtetime të cilët në një formë kanë qenë akte administrative, se komisioni si i tillë është suprimuar dhe nuk mund të bëhet fjalë për organin e shkallës së dytë për shkak se nuk ekziston si institucion në sistemin juridik etj., kolegji i Gjykatës Supreme këto pretendime dhe të tjerat si në kërkesë i shqyrtoi në tërësi, dhe vlerëson se nuk janë të bazuara në fakte të qëndrueshme dhe relevante në baza ligjore, sipas çështjes së vendosur gjat shqyrtimit paraprak të padisë dhe hedhjen e saj si jo të rregulltë, sepse me padi kontestohet Certifikata „Veteran Pjestar“, e dt. 16.04.2018, e organit të paditur, e cila sipas përmbajtjes së saj nuk paraqet akt administrativ, dhe as përfundimtar në procedurë administrative si parashihet me LPPA-së, mbi bazën e të cilit do të lejohej inicimi i konfliktit administrativ sipas dispozitave të LKA-së. Prandaj theksimet se nuk janë shqyrtuar pretendimet e palëve dhe nuk janë marrë parasysh theksimet në padi dhe deklaratat e dëshmitarëve etj., nuk mund të jenë objekt i shqyrtimit, sepse paraprakisht padia nuk i plotëson kushtet ligjore për tu trajtuar si e rregullt dhe në harmoni me dispozitat e LKA-së. Për të filluar procedurë gjyqësore në konflikt administrativ fillimisht duhet të shtjerrën mjetet juridike në procedurë administrative, ndaj qdo veprimi apo mos veprimi administrativ, nëse pala e interesuar pretendon se i është cenuar një e drejtë apo interes juridik me një akt apo mos veprim të administratës, ashtu si parashihet në nenin 124, dhe afatet nga neni 127, të LPPA, e pastaj të procedohet çështja me padi në procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ. Nga provat në shkresa të lëndës dhe parashtrësive të paditësit, nuk dëshmohet se e atakon një akt përfundimtar administrativ të organit të paditur, apo se në organin e paditur ka ushtruar mjet juridik të ankimit në ndonjë fazë të shqyrtimit të kërkesës së tij në periudhat ligjore të vendosjes nga komisioni për rishqyrtimin e kërkesave, lidhur me pretendimet e tij se i plotëson kushtet që të ketë statusin e “veteranit”, të UÇK-së, para se ti drejtohej me padi gjykatës, për tu dëshmuar se kontestohet ligjshmëria e një vendimi përfundimtar, të nxjerrë në fund të një procedure administrative, ashtu si parashihet në nenin 13, apo sipas heshtjes administrative nga neni 14 dhe 29 të LKA-së, dhe për tu vlerësuar ligjshmëria e tij në baza ligjore sipas padisë, si në kuptim të nenit 9, të këtij ligji.

Nga theksimet si më lartë Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta në këtë çështje juridike administrative, në bazë të fakteve të vërtetuara drejtë kanë vendosur çështjen në shqyrtim sipas objektit të saj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura si më lartë të LKA-së, LPA-së dhe të LPK-së, (i zbatueshëm si në kuptim të nenit 63, të LKA-së). Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktvendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, e po ashtu e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është cënuar ligji në dëm të palës paditëse.

Nga theksimet si më lartë, dhe në pajtim me nenin 54 paragrafi 1, i Ligjit për Konfliktet Administrative u vendos si së dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË  
ARJ.nr.10/2022, datë 25 Shkurt 2022

Procesmbajtës,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Ragip Namani